

VENDIM
Nr.65, datë 27.7.2011

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK ME SERI PV05P, NR.29, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.85, DATË 27.12.2005

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 13, 14 dhe 15 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k, për modifikimin e licencës nr.29, seria PV05P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Kërkesa e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Informacioni me shkrim, ku shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikim licence (neni 15, pika 4 germa “a”), është dhënë në mënyrë të detajuar.

- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës (neni 15, pika 4 germa “b”), është dhënë konform rregullores.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e licencës nr.29, seria PV05P, të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit prodhim i energjisë elektrike nga hec–“Vithkuq”.

2. Fuqia e instaluar e hec–“Vithkuq” nga 2115 kW të bëhet 2715 kW.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani